




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. I faq.	03-02/1243/1
Broj stranica	02
Nr. pages	
Data	10.05.2017
Datum	
Date	
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 08.05.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllt rasti me nr. AKK – 03-02-4691/16, për z. Zenun Shala – Drejtor Bordi në Aeroportin e Gjakovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.



A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4691/16, për z. Zenun Shala – Drejtor Bordi në Aeroportin e Gjakovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Shala, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në bizneset private N.T.P. “Sigma” dhe “Juniku i Ri” Sh.A.

Agjencia kundër Korruptionit ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në bazë të cilës fillimisht ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar takim me zyrtarin e lartë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Shala është bindur për kufizimet në ushtrimin e funksionit menaxhues në bizneset private, krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë dhe ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shhang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkojë z. Shala ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se ai ka caktuar person të autorizuar për të menaxhuar bizneset private. Me këtë ai ka shhangur situatën e konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Shaip Havollli

